Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic of Kosovo

Komuna e Rahovecit
Opstina Orahovac/Municipality Rahovec

Drejtoria për Zhvillim Ekonomik dhe Turizëm
Odeljenje za Razvoj i Turizam
Department of Development and Tourism

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E RAHOVECIT - OPŠTINA ORAHOVAC
Drejtoria për Administratë të përgjithshme
Odeljenje za Opštu Upravu
Nr. Prot. 3942 Më Dt. 12.11.2026
RAHOVEC - ORAHOVAC

THIRRJE PUBLIKE PËR APLIKIM

"Mbështetja e krijimit dhe përmirësimit të njësive për akomodim afatshkurtër turistik në Komunën e Rahovecit"

Komuna e Rahovecit, përkatësisht Drejtoria për Zhvillim Ekonomik dhe Turizëm, përmes kësaj thirrjeje fton personat fizikë dhe juridik që posedojnë ose kanë të drejtë ligjore shfrytëzimi të njësive të përshtatshme për akomodim afatshkurtër në Komunën e Rahovecit, të aplikojnë për mbështetje financiare përmes subvencioneve.

1. Synimet e Thirrjes

Synimi i përgjithshëm i thirrjes është rritja e kapaciteteve akomoduese për turistët dhe vizitorët në Komunën e Rahovecit, duke adresuar mungesën e ofertës së mjaftueshme të akomodimit.

Synimet specifike të kësaj thirrjeje janë:

1. Krijimi dhe funksionalizimi i njësive të reja për akomodim afatshkurtër turistik.

2. Përmirësimi i cilësisë dhe standardeve bazë të njësive ekzistuese akomoduese.

3. Rritja e ofertës turistike, me përparësi për njësitë në qytetin e Rahovecit.

2. Përkrahja financiare e ofruar nga autoriteti kontraktues

Shuma e përgjithshme indikative për këtë thirrje është 18,000.00 €. Parashihet mbështetja e deri në 9 përfituesve, me subvencion maksimal deri në 2,000.00 € për përfitues, në varësi të vlerësimit dhe mjeteve në dispozicion.

Subvencioni do të jepet për:

– Pajisje dhe mobilim të nevojshëm për akomodim (shtretër, dyshekë, tekstile, pajisje bazë sanitare dhe të kuzhinës);
– Përmirësime të vogla funksionale dhe të sigurisë, të lidhura drejtpërdrejt me shërbimin e akomodimit;
– Pajisje për internet dhe elemente të identifikimit/informimit të mysafirëve.

Nuk financohen blerja e pronës, ndërtimi i objekteve të reja, shpenzimet operative, shpenzimet e kryera para miratimit të subvencionit ose investimet që nuk lidhen me akomodimin turistik.

3. Kriteret e aplikimit:

Të drejtë aplikimi kanë personat fizikë dhe bizneset që plotësojnë këto kushte:

– Të jenë shtetas të Republikës së Kosovës dhe të kenë të drejtë të ligjshme pronësie ose shfrytëzimi mbi njësinë e propozuar në territorin e Komunës së Rahovecit;

– Njësia të jetë banesë, apartament ose njësi tjetër e veçantë dhe e përshtatshme për akomodim afatshkurtër; nuk pranohen hotelet dhe shtëpitë individuale;

– Njësia të ketë mundësi reale për akomodim të turistëve, kushte higjienike, sanitare dhe të sigurisë, si dhe qasje funksionale;

– Aplikanti të mos ketë detyrime të papaguara ndaj Komunës së Rahovecit, sipas vërtetimit përkatës;

– Të paraqesë projekt-propozim me buxhet, fotografi të gjendjes aktuale dhe plan për vënien e njësisë në funksion;

– Të angazhohet që njësia të ofrohet publikisht për rezervime afatshkurtra, përmes Airbnb, Booking ose kanaleve të tjera të rezervimit, pas përfundimit të investimit.

Përparësi në vlerësim u jepet njësive që ndodhen në zonën urbane të qytetit të Rahovecit, njësive që krijojnë kapacitete të reja dhe projekteve që mund të funksionalizohen brenda një afati të shkurtër. Përparësia e lokacionit nuk përjashton aplikimet nga vendbanimet e tjera të komunës.

Dokumentet e nevojshme për aplikim

• Formulari i aplikimit dhe projekt-propozimi me preventiv/kosto të planifikuara;

• Kopja e letërnjoftimit të aplikantit ose përfaqësuesit të autorizuar;

• Dëshmia e pronësisë ose kontrata e vlefshme e shfrytëzimit, me pëlqimin e pronarit për veprimtarinë dhe investimin;

• Fotografitë e njësisë dhe përshkrimi i kapacitetit të planifikuar (numri i shtretërve/mysafirëve);

• Vërtetimi për obligimet ndaj Komunës së Rahovecit;

• Konfirmimi i xhirollogarisë bankare;

• Për bizneset e regjistruara: certifikata e biznesit dhe dokumentet tatimore të kërkuara sipas rregullave në fuqi.

Vërejtje: Përfituesit obligohen të nënshkruajnë kontratë me Komunën, të dokumentojnë shpenzimet dhe të lejojnë verifikimin e investimit. Kushtet e regjistrimit, operimit, raportimit dhe periudha minimale e funksionimit do të përcaktohen në kontratë, në përputhje me legjislacionin në fuqi, gjithashtu përfitues mund të jetë vetëm një aplikues për një njësi.

4. Mënyra e Aplikimit

Afati për dorëzimin e aplikacioneve: nga data 16.11.2026 deri më 30.11.2026, formulari mund të tërhiqet në sportelin nr. 8 në administratën komunale, ofertat duhet të jenë në origjinal dhe kopje.

Për informata shtesë: +383 49 884 575.

Data 12.06.2026, Rahovec